



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E MJEDISIT

MAJ 2026

# BULETINI MUJOR

MINISTRIA E MJEDISIT



## ↘ Mbahet në Tiranë Konferenca "United for Climate"

Konferenca Rajonale e Klimës, e organizuar nga Ministria e Mjedisit, mbledhi në Tiranë përfaqësues të institucioneve kryesore ndërkombëtare dhe rajonale, duke forcuar bashkëpunimin dhe angazhimet e përbashkëta për përballimin e sfidave klimatike.



## Ministri Jaupaj Mirëpret në Tiranë ↙ homologun e Malit të Zi

Ministri Sofjan Jaupaj priti në një takim bilateral Ministrin e Mjedisit të Malit të Zi, Damjan Ćulafić, ku u diskutua bashkëpunimi për mbrojtjen e Liqenit të Shkodrës dhe lumit Buna, si dhe avancimi i objektivave të Kapitullit 27 dhe Agjendës së Gjelbër për Ballkanin Perëndimor.

## ↘ Takim me misionin e "Fund for Responding to Loss and Damage"

Gjatë Konferencës Rajonale "United for Climate", Ministri Jaupaj u takua me Znj. Mathilde Laurans për të diskutuar mekanizmat "Loss & Damage" dhe forcimin e sistemeve që lidhin parashikimet klimatike me reagimin institucional dhe mbështetjen financiare për komunitetet më të prekura.



## Diskutim mbi iniciativat rajonale për pyjet ↙

Ministri Jaupaj diskutoi me përfaqësues të Maqedonisë së Veriut dhe FAO-s mbi një iniciativë rajonale për pyjet, që synon restaurimin e tyre, menaxhimin e riskut nga zjarret dhe forcimin e kapaciteteve përballë ndryshimeve klimatike, me mbështetjen e Green Climate Fund dhe FAO.



## Përmbillet me sukses fushata "Shtigje të Pastra, Pyje të Mbrojtura"

Gjatë muajit maj, në 12 qarqe të vendit u zhvillua fushata "Shtigje të Pastra, Pyje të Mbrojtura", duke angazhuar nxënësit në aktivitete edukative dhe praktike për mbrojtjen e mjedisit dhe ndërgjegjësimin për ruajtjen e natyrës.

## Monaco Blue Initiative: Shqipëria prezanton vizionin e saj mjedisor

Në këtë forum prestigjioz ndërkombëtar, Shqipëria prezantoi vizionin dhe politikat e saj mjedisore për mbrojtjen e biodiversitetit, forcimin e zonave të mbrojtura dhe rolin që diplomacia mjedisore luan sot në bashkimin e vendeve për një të ardhme më të qëndrueshme e më të sigurt për brezat që vijnë.



## Takime me drejtues të Oceanographic Institute of Monaco dhe Prince Albert II Foundation

Gjatë takimit u dakordësua nisja e një projekti bilateral shkencor për vitin 2027, i fokusuar në monitorimin e zonave të mbrojtura detare në Shqipëri. Nisma synon forcimin e kërkimit shkencor, mbrojtjen e biodiversitetit detar dhe zhvillimin e politikave të qëndrueshme për ruajtjen e natyrës.



## Ministri Jaupaj në takim me Drejtoreshën e Përgjithshme të IUCN

U finalizua marrëveshja që e vendos IUCN-në si partner strategjik të Shqipërisë për negociimin e nënkapitullit të Natyrës dhe Biodiversitetit në kuadër të Kapitullit 27 me BE-në. Gjithashtu, u diskutua bashkëpunimi në projekte dhe financime për mbrojtjen e biodiversitetit dhe zonave të mbrojtura.



## ↘ New York, në Forumin e Kombeve të Bashkuara për Pyjet

Ministri Sofjan Jaupaj prezantoi reformat dhe vizionin për transformimin e sektorit pyjor, duke e pozicionuar atë si një prioritet strategjik për mbrojtjen e klimës, biodiversitetit dhe zhvillimin e qëndrueshëm të vendit.



## Ministri Juapaj zhvilloi takime në selinë qendrore të UNDP në New York ↘

Ministri Jaupaj zhvilloi takime me drejtues të lartë të OKB-së, ku u diskutua mbështetja për tranzicionin e gjelbër, investimet për klimën e biodiversitetin, si dhe forcimi i kapaciteteve institucionale në procesin e integritimit evropian.



## ↘ Prezantohen projektet fituese të Konkursit Kombëtar "Kullat e Vrojtimit"

Tre projektet fituese të Konkursit Kombëtar "Kullat e Vrojtimit - Inteligjenca Natyrore, Artificiale & Kolektive" u prezantuan nga studentë të arkitekturës, duke sjellë ide inovative që ndërthurin teknologjinë, arkitekturën dhe mbrojtjen e natyrës. Konkursi promovoi rolin e të rinjve në zhvillimin e zgjidhjeve të qëndrueshme për zonat e mbrojtura të vendit.



## Shqipëria zyrtarisht anëtare e Këshillit Ndërkombëtar për Ruajtjen e Gjuetisë dhe Faunës ↘

Ministri i Mjedisit mori pjesë në një tryezë të nivelit të lartë sëbashku me Federatën e Gjuetarëve të Shqipërisë, ku u diskutua kalimi drejt një modeli modern dhe të bazuar në shkencë për menaxhimin e faunës së egër dhe burimeve natyrore, në përputhje me standardet europiane dhe kuadrin e ri ligjor të vendit.



## ↙ Miratohet ligji për transferimin e varësisë së AMBU pranë Ministrisë së Mjedisit

Miratimi i këtij ligji përcaktohn Ministrinë e Mjedisit si institucionin politikbërës në fushën e ujërave në Shqipëri. Ky, një hap i rëndësishëm drejt forcimit të qeverisjes së burimeve ujore, koordinimit institucional dhe menaxhimit të qëndrueshëm të ujit, në përputhje me standardet e BE dhe objektivat e Kapitullit 27 për anëtarësimin e Shqipërisë në Bashkimin Evropian



## Zhvillohet takimi i komitetit të parë drejtues të projektit Vjosa e Gjelbër ↘

Në mbledhjen e parë të Komitetit Drejtues të projektit "Green Vjosa", u lançua investimi prej 3 milionë eurosh në partneritet me Qeverinë Gjermane, për mbrojtjen e biodiversitetit të Vjosës dhe zhvillimin e qëndrueshëm të komuniteteve lokale. Projekti do të zbatohet deri në vitin 2029, duke lidhur ruajtjen e natyrës me turizmin e qëndrueshëm dhe ekonominë e gjelbër.

## ↙ Ministri Jaupaj vizitë në liqenin e Shkodrës

Në Shirokë, pranë Liqenit të Shkodrës, Ministri Jaupaj diskutoi me partnerët lokalë dhe Z. Benet Beci mbi potencialin e kësaj pasurie natyrore. Me dosjen tashmë të dorëzuar në UNESCO, fokusi mbetet rritja e projekteve ndërkombëtare, promovimi dhe integrimi i saj në ofertën ekoturistike të Shqipërisë.



## Vizitë në Landfillin Rajonal të Bushatit ↘

Gjatë një vizite pune në landfill, Ministri Jaupaj ndoqi nga afër funksionimin e infrastrukturës së menaxhimit të mbetjeve. Gjithashtu, u diskutua financimi i fazës së tretë të investimit, që përfshin qendra MRF, impiant kompostimi, sistemin e menaxhimit të gazit metan dhe zgjerimin e landfillit, në bashkëpunim me AKEM sh.a.

## Shkodër, Ministri Jaupaj ne takim me Kryetarin e Bashkisë Z. Benet Beci

U diskutua ecuria e procesit të pastrimit në qytet dhe investimet për përmirësimin e infrastrukturës së menaxhimit të mbetjeve. Gjithashtu, u konfirmua vijimi i bashkëpunimit me Bashkinë e Shkodrës për menaxhimin e qëndrueshëm të zonave të mbrojtura dhe zhvillimin e ekoturizmit.



## Zhvillohet takimi i radhës për zgjidhjet e qëndrueshme për menaxhimin e mbetjeve

Së bashku me ambasadorën e Francës, Catherine Suard, Ministri Jaupaj diskutoi mbi zgjidhjet e qëndrueshme për menaxhimin e mbetjeve në rajonet Tiranë-Durrës, Elbasan dhe Fier. Projekti, i mbështetur nga granti FASEP i Thesarit Francez, synon modernizimin e sistemit të menaxhimit të mbetjeve në përputhje me standardet e Bashkimit Europian dhe parimet e ekonomisë qarkulluese.



## Zhvillohet takimi mbi projektligjin e Shoqërisë Shtetërore të Pyjeve

Në tryezën e diskutimit për projektligjin e Shoqërisë Shtetërore të Pyjeve, u shqyrtuan komentet dhe sugjerimet e ekspertëve dhe aktorëve të interesuar për ndërtimin e një modeli modern dhe të qëndrueshëm të menaxhimit pyjor, në përputhje me standardet europiane.



## Një takim i rëndësishëm me përfaqësuesit e BirdLife International

Në takim me BirdLife International, një nga organizatat më të mëdha mjedisore në botë, për të ndërtuar një platformë të qëndrueshme partneriteti që mbështet arritjen e pikave mbyllëse të Kapitullit 27 në rrugën tonë drejt integritetit evropian

